# KUSHTET PËR RINDËRTIM TË NDËRTESAVE

KATEGORIA I

BAZA LIGJORE: LIGJI NR. 04/L-110 PËR NDËRTIMIN, LIGJI NR. 04/L-174 PËR PLANIFIKIMIN HAPËSINOR, LIGJI NR. 04/L-013 PËR KADASTËR, LIGJI NR.02/L-28 PËR PROCEDURËN ADMINISTRATIVE ME KUSHTET NDËRTIMORE NËNKUPTOHEN KUSHTET E PËRCAKTUARA NGA PLANET RREGULLATIVE URBANE, OSE NË MUNGESË TË PLANEVE MUND TË PROPOZOHEN NGA KËRKUESI KUSHTE NË DIAMETËR 50 M NGA SKAJET E PARCELËS E QË APROVOHEN NGA ORGANI KOMPETENT. SHËRBEJNË SI BAZË PËR HARTIMIN E DOKUMENTACIONIT NDËRTIMOR DHE PËRCAKTOJNË LLOJIN, MADHËSINE, MËNYRËN E NDËRTIMIT, KUSHTET E SIGURISË, DHE ÇFARËDO KUSHTI TJETËR TË DOMOSDOSHËM PËR NDËRTIME NDËRSA ME RINDËRTIM NËNKUPTOJMË PUNË NDËRTIMORE QË KA PËR SYNIM NDRYSHIMIN SUBSTANCIAL TË NJË NDËRTIMI, PËR SHEMBULL:

- NDËRTIM I KATIT TË RI TË NJË NDËRTESE OSE LARGIM I NJË KATI EKZISTUES, SI DHE NDRYSHIM I GABARITIT TË NDONJËRIT KAT PËR MË SHUMË SE NJË (1) METËR;
- NDRYSHIM I MADHËSISË SË ELEMENTEVE ARKITEKTURORE TË PJESËS SË JASHTME PËR MË SHUMË SE DY PËRQIND (2 %) DHE ZERO PRESJE NJË (0,1) METËR;
- ZËVENDËSIM, LARGIM, OSE RIPARIM I PJESËVE STRUKTURORE TË NDËRTIMEVE;
- NDRYSHIM I PROJEKTIT EKZISTUES SIPAS TË CILIT PARAPRAKISHT ËSHTË LËSHUAR ÇERTIFIKATA E SHFRYTËZIMIT;
- MODIFIKIM, ZGJERIM OSE REDUKTIM I SISTEMEVE TË SHËRBIMEVE PUBLIKE PËR PËRDORIM TË PËRBASHKËT NË NDËRTIM

## APLIKIMI

1 PLOTËSIMI I APLIKACIONIT PËRKATËS

2 NDËRTESA E KOMUNËS

3 LAGJA ARBËRIA, RR. "AHMET KRASNIQI"

## KOMPLETIMI DHE DORËZIMI I DOKUMENTACIONIT TË NEVOJSHËM

1 KOPJA E PLANIT DHE CERTIFIKATA E PRONËSISË TË PRONARIT-RES/ PRONARËVE TË PARCELËS (DËSHMIA MBI PRONËN JO MË E VJETËR SE 6 MUAJ NË FORMATIN ORIGJINAL OSE TE FOTOKOPJUAR DHE TË VËRTETUAR NGA NOTERI. KOPJET E PLANIT TË PARCELAVE KADASTRALE DUHET TË JENË TË HARMONIZUARA ME VEKTORËT KADASTRAL)

2 VËRTETIMI I TATIMIT NË PRONË TË PRONARIT-RES/ PRONARËVE TË PARCELËS DHE INVESTITORIT *

3 FOTOKOPJA E DOKUMENTIT TË IDENTIFIKIMIT TË PRONARIT PRONARËVE TË PARCELËS DHE INVESTITORIT.

4 INÇIZMIMI GJEODEZIK I PARCELES (NE SISTEM SHTETËROR KOSOVA REF. 01) DHE SIPËRFAQES NË DIAMETËR PREJ 50M PREJ KUFIRIT TË PARCELËS. (TË PËRGADITET NGA KOMPANIA E LICENSUAR GJEODEZIKE DHE DORËZIMI TË BËHET NË FORMATIN DIGJITAL EDHE NË KOPJE TË FORTË)

5 PËLQIMI I NOTERIZUAR NGA PRONARËT E PARCELAVE FQINJË PËR SIGURIMIN E QASJES DERI NË RRUGË PUBLIKE. (VETËM PËR PARCELAT QË NUK KANË QASJE NË RRUGË, MARRËVESHJE E NOTERIZUAR ME FQINJËT NËPËR PRONËN E TE CILËVE KALON RRUGA) **

6 PROJEKTI I GJENDJES EKZISTUESE DHE PROPOZIMI PËR RINDËRTIM, ME PËRSHKRIMIN TEKNIK PËR PUNËT QË KËRKOHET TË ZHVILLOHEN ME RINDËRTIM. (NGA KOMPANIA PËR PROJEKTIM)

7 ANALIZA E STABILITETIT TE NDËRTESËS EKZISTUESE DHE NDIKIMI I RINDËRTIMIT NË ATË NDËRTESË. (NGA EKSPERTI I LËMISË APO KOMPANIA E LICENSUAR)

8 INFORMATA NGA PLANI (PZHU,PZHK OSE PRRU)

9 PËLQIMI NGA FQIU KUR PJESA E NDËRTESËS PËR TË CILËN KËRKOHET RINDËRTIMI OFROHET NE DISTANCË MË TË VOGËL SE TË PARAPARË ME KRITERET E PLANIT, OSE RINDËRTOHET NË KUFI TË PARCELËS ME FQIUN. (MARRËVESHJE E NOTERIZUAR) **

10 FOTOGRAFI TE LOKACIONIT (DUKE PËRFSHIRË PARCELËN DHE NDËRTESAT PËRRETH DERI NË DIAMETËR PREJ 50M)

11 LEJA E NDËRTIMIT APO LEJA E LEGALIZIMIT TË NDËRTESËS EKZISTUESE (ME DOKUMENTACIONIN TEKNIK). (NË RAST SE NDËRTESA ËSHTË NË PROCEDURË TË LEGALIZIMIT, VËRTETIMI QË NDËRTESA FIGURON NË REGJISTRIN E NDËRTIMEVE PA LEJE)

12 DËFTESË PAGESA E TAKSËS KOMUNALE

## VENDIMI

MAKSIMUM 15 DITË PUNE, NGA DITA E PRANIMIT TË DOKUMENTACIONIT

VËREJTJE:

* POLITIKË E KOMUNËS PËR MBLEDHJEN E TATIMIT NË PRONË

** KËRKESA PLOTËSUESE PËR DEFINIM TË PRONËS

ME KUSHTE NDËRTIMORE PËRCAKTOHET NËSE DO TË KETË NEVOJË PËR MARRËVESHJEN PËR SHPRONËSIMIN E PRONËS NË HAPËSIRË PUBLIKE (RRUGË, GJELBËRIM, QERDHE, SHKOLLE, AMBULANCE...ETJ OSE TRANSFER TË KOEFICIENTËVE-KY PROCESS REALIZOHET NË DREJTORINË E FINANCAVE DHE PRONËS, ME PROPOZIM NGA DREJTORIA E URBANIZMIT), MËNYRA E RIPARCELIMIT (BASHKIMIT OSE NDARJES SË PARCELAVE KADASTRALE- KY PROCES REALIZOHET NË DREJTORINË E KADASTRIT, ME PROPOZIM-PËLQIM NGA DREJTORIA E URBANIZMIT) SI DHE NDËRRIMIT TË LLOJIT TË SHFRYTËZIMIT TË TOKËS (KY PROCES REALIZOHET NË DREJTORINË E KADASTRIT, ME PROPOZIM-PËLQIM NGA DREJTORIA E URBANIZMIT SIPAS PËLQIMIT TË MBPZHR)

Schweizerische Eidgenossenschaft
Confédération suisse
Confederazione Svizzera
Confederaziun svizra
Swiss Cooperation Office Kosovo

UNDP
Empowered lives.
Resilient nations.